



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 176/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së lartë Ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Organizatave Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), dhe BIRN dhe Internews Kosova, të dyja me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të pjesëtarëve të institucioneve shtetërore, në spot publicitar gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 04.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHEN** si të bazuara ankesat Anr. 176/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), dhe ankesa Anr.189/2019, e datës 02.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, të dyja me seli në Prishtinë, kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak se me datën 30.09.2019, është publikuar spoti publicitar i koalicionit AAK-PSD, në kanal zyrtar të liderit të koalicionit, në të cilin spot shihet edhe përdorimi i resurseve shtetërore për qëllime të fushatës, ashtu që koalicioni në spotin publicitar nga sekonda e 13 deri në 21 paraqet zjarrfikësit dhe automjetet e shërbimit të zjarrfikësve, i **SHQIPTOHET** gjobë në lartësi prej 9,600.00€ (nëntëmijë e gjashtëqind euro), të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

**II. Urdhërohet** koalicioni AAK-PSD, që brenda afatit prej 24 orëve nga pranimi i këtij vendimi, të përmirësoj shkeljet e konstatuara si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. Ankimimi kundër këtij vendimi nuk e ndalon ekzekutimin sipas pikës II, të këtij vendimi.

## A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 01.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.176/2019, nga Organizata Joqeveritare Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), dhe ankesën Anr.189/ e datës 02.10.2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, të dyja me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, ku në ankesën e KDI-së, Anr.176/2019, theksohet se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend ka vërejtur një parregullsi, ku me datën 30.09.2019, është publikuar një spot publicitar i koalicionit AAK-PSD, në kanal zyrtar të liderit të koalicionit, në të cilin spot ndër të tjera shihet edhe përdorimi i resurseve shtetërore për qëllime të fushatës, ashtu që koalicioni në spotin publicitar nga sekonda e 18 deri në 21 shfrytëzon dhe paraqet zjarrfikësit dhe automjetet e shërbimit të zjarrfikësve, ndërsa në ankesën e BIRN dhe Internews Kosova Anr.189/2019, theksohet se me datë 2 Tetor 2019, rreth orës 12, kanë vërejtur se kandidati

për kryeministër Ramush Haradinaj, ka shpërndarë një video në të cilën ka përfshire pamjet e disa pjesëtareve të shërbimit të zjarrfikësve, në të cilën bën thirrje për të dalë për të votuar.

Paraqitësit e ankesave theksojnë se me këto veprime koalicioni AAK-PSD, ka shkelur nenin 35 të LZP-së, dhe nenin 6 të Rregullores Zgjedhore Nr.11, dhe rregullores nr.13/2013, e plotësuar me rregulloren 20/2019, saktësisht nenin 5.2 par. a).

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, paraqitësit e ankesave kanë bashkangjitur ankesës nga një CD.

Paneli, në bazë të nenit 13 paragraf 2, të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka vendosur të bashkojë ankesat e lartcekura dhe të i trajtojë si një ankesë, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të gjitha të vendos me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në përgjigjen në ankesë të koalicionit AAK-PSD, të datës 02.10.2019, dhe të datës 03.10.2019, në të cilat deklarohet se spoti publicitar, në fjalë është xhiruar nga aktorë dhe jo nga zjarrfikësit, ku sipas tyre shifet qartë gjestet që bëjnë në spot, aktoret të performanca në frymarrje, dhe në rast se paditësi ka argumente se janë zjarrfikësit e ndonjë brigade të vërtetë le ti paraqesë me fakte.

Me tutje në përgjigje në ankesë theksohet se PZAP-i, të marrë për bazë veprimet e AAK-PSD që është paraparë në Rregulloren Nr.11/2013 neni 3 3.3, 3.4 dhe 3.6, për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve, që të respektojnë ligjin në fuqi dhe rregulloren e kodit të mirësjelljes.

Koalicioni AAK-PSD, përgjigjes në ankesë, si provë i ka bashkangjitur disa njoftime që koalicioni në fjalë ka bërë në rrjetet sociale, për anëtarët dhe simpatizantët e tij lidhur me respektimin e rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 2, të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është bazuar**

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës si CD-në, e ofruar si provë materiale, e cila është publikuar në llogarinë e facebook-ut, të kandidatit për kryeministër të Kosovës, Ramush Haradinaj, përgjigjes në ankesë të koalicionit AAK-PSD, dhe shkresave tjera të lëndës, shihet qartë se janë përdorur zjarrfikësit aktiv të uniformuar, automjetet e zjarrfikësve dhe objekti i tyre për raste urgjente, dhe ka vlerësuar se nga ana e koalicionit AAK-PSD, është shkelur neni 35.1 dhe neni 35.2, i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme LZP-së, i cili përcakton se:” *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyre ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”, dhe neni 35.2 i cili përcakton se: “ *Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik”.**

Pretendimi si në përgjigje e koalicionit AAK-PSD, se në këtë rast spoti publicitar, në fjalë është xhiruar nga aktorë dhe jo nga zjarrfikësit, është i pa bazuar, edhe sikur zjarrfikësit nuk janë real, në spot janë përdorur automjetet e zjarrfikësve dhe objekti i tyre për raste urgjente, andaj shkeljet janë evidente nga neni 35 par. 1 dhe 2, të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme LZP-së.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.


Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se dy subjektet e koalicionit në fjalë, subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti gjatë fushatës zgjedhore, në spotin e tyre zgjedhor kanë përfshirë pjesëtarë të shërbimit të zjarrfikësve aktiv, veprim ky i sanksionuar me dispozitat e lartcekura të rregullave zgjedhore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, e mori edhe faktin që koalicionit në fjalë, i është dhënë mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta përmirësojë shkeljen e bërë, mirëpo subjekti politik megjithëse e ka pranuar shkeljen e bërë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me atë se është bërë përmirësimi i shkeljes siç kërkohet me nenin 120 paragrafi 1 pika a) e LPZ-së, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 35 paragrafi 1, dhe 2, nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 2 i Rregullës Nr. 01/2012, Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjjobave të PZAP-it.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.176/2019 më datë 04.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
Fejzullah Rexhepi



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.